



Raport Muor Mars 2022

Informacion bazë

Emri i Fondit	Raiffeisen MIKS
Administrimi i Fondit	Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	Euro
Datë Lancimi	16 Nëntor 2020
Vlera fillestare e kuotës	100
Shuma fillestare minimale	500 Euro
Vlera neto e Aseteve	EUR 3,492,609
Cmimi i kuotës	987.2228
Banka depozitare	Banka e Pare e Investimit, Albania
Banka nëndepozitare	Raiffeisen Bank International, Austria
Kthimi vjetor nga investimi ne 31 Mars 2022	-3.17%

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	0.00%
Tarifë në dalje	0.00%
Tarifë administrimi vjetore	Deri në 1.30%
Tarifa te tjera te vazhdueshme	Kalkulohen ne fund te vitit kalendarik dhe perfshijne tarifën e paguar ndaj bankes depozitare, auditorit të jashtëm, autoritetit rregullator apo kostot për komunikimin e ndryshimeve në prospekt.
Komisione/tarifa të vazhdueshme	1.55% per vitin 2021
Komisione të transfertës nga shlyerja e kuotave	Referojuni informacionit ne deget e RBAL
Kosto të transaksioneve	Sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese

Objektivi dhe Politika e investimit

Objektivi i investimit të Fondit është krijimi i të ardhurave të rregullta dhe një rritje e moderuar e kapitalit në një periudhë afatmesme. Asetet e fondit investohen në instrumente financiare që i përkasin tre kategorive kryesore te asetëve: Tituj borxhi, Aksione, Tregu i parasë dhe ekuivalentë cash-i. Në mënyrë që të arrihet qëllimi i investimit, fondi investon deri në 75% të totalit të asetëve në Tituj borxhi, të cilat emetohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, një vend i BE-së apo çdo shtet tjetër i miratuar nga rregullatori vendas, nga institucionet ndërkombëtare

dhe / ose shoqëri tregtare. Për më tepër, për të maksimizuar kthimin total nga investimi, fondi mund të investojë deri në 40% të asetëve në aksione, kryesisht të tregtuar në tregjet e zhvilluara në SH.B.A. dhe Europë. Nëse do të përdoren instrumente financiare derivative, qëllimi do të jetëz butja e risqeve dhe arritja e objektivave të politikës së investimit, por faktorë të tillë si likuiditeti i instrumentit tek i cili mbështetet derivativi dhe luhatshmëria e vlerës së tij mund të ndikojnë në performancën e fondit.


Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Risk i ulët

Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë


Përfitimet tipike më të larta



Profili i parashikuar i rrezikut të Fondit Raiffeisen Miks i përket kategorisë së katërt të treguesit të rrezikut sintetik dhe përfitimit.

Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes së luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik. Ky tregues ka për qëllim t'ju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

Struktura e Portofolit të Investimit



Portofoli i fondit Miks është i ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga investimi dhe diversifikimi në të dy kategoritë e asetëve siç janë obligacionet dhe aksionet. Politika e investimit është ende në procesin e implementimit.


Portofoli i Titujve është i përbërë nga 28.9% e totalit të asetëve në tituj borxhi të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe 23.6% nga tituj borxhi të korporatave dhe nga fonde investimi që investojnë në obligacione. Pjesa e aksioneve (25.7%) është e investuar kryesisht në tregje të zhvilluara: SHBA 10.2%; Zona Euro 11.5% Britani e Madhe 2.2% e asetëve totale.

Performanca e fondit

Fondi ka shfaqur ecuri negative gjatë muajit Mars. Çmimi i kuotës është ulur me **-1.36%** krahasuar me muajin Shkurt.

Tregu i obligacioneve ka vijuar të ketë një ecuri negative me rritje të ndjeshme të normave të interesit edhe gjatë muajit Mars, për shkak të frikës së rritjes së inflacionit dhe perspektivës së shtërngimit të politikave monetare nga Bankat Qendrore për të luftuar këtë inflacion. Të gjitha këto shkaktojnë një rivlerësim negativ të portofolit të obligacioneve të fondit Mix. Nga ana tjetër, një perspektivë më e mirë është vënë re në tregjet e aksioneve, të cilat kanë performuar pozitivisht në gjysmën e dytë të muajit. Megjithatë, rritja e aksioneve ishte e moderuar dhe nuk mundi të shkaktojte një rivlerësim pozitiv të portofolit të investimeve të fondit Mix, i cili shënoi humbje gjatë këtij muaji. **Kthimi vjetor neto i fondit Mix ishte -3.17% më 31 Mars 2022.**

Ecuria e Çmimit të kuotës Fondi Miks



Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Luhatshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur.

Investitorët e fondit Raiffeisen Miks dhe te gjithë fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfutur nje

kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond te nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga pandemia globale, sepse ne kete menyre nuk do te rrezikojne te dalin nga fondit ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Zhvillimet dhe informacion mbi ecurinë e tregjeve financiare gjate muajit Mars

Ndërsa lufta midis Rusisë dhe Ukrainës vazhdon, perspektiva duket më pozitive për shkak të shpresave për arritjen e një marrëveshjeje midis palëve, ndërsa bisedimet po përparojnë.

Përveç luftës, inflacioni vazhdon të jetë një nga problemet më të mëdha me të cilin po përballlet ekonomia. Rritja e inflacionit total në BE nga 5.9% në Shkurt në 7.5% në Mars ishte shumë më e lartë se parashikimi i publikuar konsensual. Ndërkohë, norma vjetore e inflacionit në SHBA u rrit në 7.9%, më e larta që nga Janari i vitit 1982, në përputhje me pritshmëritë e tregut. Megjithatë, çmimet e naftës kanë rënë rreth 7% këtë muaj, duke u mbyllur me një vlerë pak më të lartë se 100 dollarë.

Në vazhdim, duke nënvizuar alarmimin mbi inflacionin që është pothuajse trefishi i objektivit zyrtar prej 2%, BQE vendosi të ngadalësojë blerjen e obligacioneve. Zyrtarët mund të vendosin të ndalojnë programin në tremujorin e tretë. FED, nga ana tjetër, filloi ciklin e saj shtrëngues me një rritje prej 25 pikë në Mars dhe do të vazhdojë me rritje të tjera përgjatë takimeve të vitit. Tregu i obligacioneve ka shfaqur sërish një ecuri negative gjatë këtij muaji, me yield-

et në rritje të ndjeshme dhe çmimet në rënie. Në fakt, yield-i i obligacioneve të thesarit 10-vjeçare arriti në 2.5% dhe yield-i i obligacioneve gjermane 10-vjeçare arriti në 0.65%. Akoma më shqetësuese janë përmbysjet e fundit në pjesë të kurbës së yield-it në SHBA, duke përfshirë spread-in midis obligacioneve 10-vjeçare dhe 2-vjeçare që shpesh shihet si një parashikues i recesioneve në SHBA. Edhe pse kurba nuk është më e përmbysur, një rrafshim i saj është ende i dukshëm, si dhe një diferencë e reduktuar midis obligacioneve 2 dhe 10 vjeçare. Meqenëse frika për rritjen e inflacionit dhe normave të interesit do të vazhdojë për njëfarë kohe, perspektiva për tregun e obligacioneve duket shumë e pasigurt.

Përkundrazi, një ndjesi relativisht optimiste është e dukshme në tregjet e aksioneve, të cilat kanë performuar pozitivisht në gjysmën e dytë të muajit, duke rikuperuar humbjet nga fillimi i luftës. S&P 500 u rrit 8.5% që nga niveli minimal i datës 8 mars. Është një rritje e moderuar dhe ende hasen luhatshmëri, por tendenca kryesore për momentin është që aksionet të performojnë më mirë se obligacionet.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe eforcashitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sh.a., në web site www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.